



Misioni në Kosovë

Misionit të OSBE-së në

Kosovë i është besuar roli

udhëheqës për çështjet që

kanë të bëjnë me ndërtim

institucional dhe të

demokracisë, me shtet ligjor

dhe me të drejta të njeriut

në rajon. Misioni e formon

kështu një komponentë të

veçantë apo "degë" të

Administratës së Përkohshme

të Misionit të Kombeve të

Bashkuara në Kosovë

(UNMIK), dhe ndër të tjera

është përgjegjëse edhe për

trajnimin e administratorëve

të policisë, civil dhe ata të

drejtësisë; vazhdimin e

zhvillimit të shoqërisë civile;

përkrahjen e zhvillimit të

mediave; organizimin dhe

mbikqyrjen e zgjedhjeve; dhe

mbikqyrjen, mbrojtjen dhe

përparimin e të drejtave

të njeriut.



ORGANIZATA PËR SIGURI DHE BASHKËPUNIM NË EVROPË

# Misioni në Kosovë

## OSBE-ja dhe Ngritja e Kuadrove

### Roli i OSBE-së në Kosovë

Siç sygjeron vetë emri, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë ka të bëjë me avansimin e një të ardhme më të sigurtë përmes bashkëpunimit. Duke punuar me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë, OSBE-ja ndihmon demokracitë që lindin si dhe ndihmon në stabilizimin dhe rindërtimin e shoqërive të pasluftës. Në Kosovë, OSBE-ja njihet si shtylla e "ndërtimit të institucioneve". Kjo do të thotë se ne përqëndrohemi në sektorët që janë qenësorë për funksionimin e mirëfilltë të një shoqërie demokratike, në të cilën OSBE-ja njihet si eksperte në lëminë e mediave, të drejtat e njeriut, zgjedhjet, përkrahjen e OJQ-ve të orientuara kah komunitetet, punën me partitë politike, mbështetjen e sundimit të ligjit. Pjesë e përbashkët e punës sonë në të gjitha këto fusha është ngritja e kuadrove (ndërtimi i kapaciteteve).

### Ngritja e kuadrove

Ngritja e kuadrove (ndërtimi i kapaciteteve) përfshin shumë elemente, atë njerëzor, teknologjik, organizativ, financiar, kulturor dhe institucional. Qëllim kryesor është rritja e aftësive të njerëzve, institucioneve dhe shoqërisë në përgjithësi, zhvillimi i potencialit të tyre, shfrytëzimi më i mirë i burimeve ekzistuese dhe avansimin e potencialit të ri.

Forma më e qartë e aftësimit është zhvillimi i shkathtësive dhe efikasitetit si te individët ashtu edhe te institucionet përmes trajnimit. Ky është niveli "më i ulët", ndërsa te niveli "më i lartë", ai i një sektori të caktuar apo i shoqërisë në tërësi, ekzistojnë disa elemente tjera. Ngritja e kuadrove ka të bëjë me përmirësimin e bashkëpunimit, përkrahjen e ndryshimeve në politikën institucionale, administrative dhe të ambientit. Është fjala për një qasje multidisiplinare në planifikim dhe realizim duke vënë theksin në ndryshimin organizativ dhe teknologjik, idetë e reja dhe risitë, gjetjen e mënyrave për të pasur një proces afatgjatë. Pra është fjala për zgjidhjen e problemeve, duke përfshirë njerëzit në proces dhe duke inkurajuar ata për të marrë përgjegjësinë për veprimet e tyre.

### Sfidat në Kosovë

Ngritja e kuadrove kërkon ndieshmëri. Pothuajse të gjitha masat e ngritjes së kuadrove në shtet, shoqëri civile dhe në nivel të sektorëve privat kanë ndikime politike dhe prekin çështjet e pushtetit dhe interesave vetjake. Kosova nuk ndryshon në këtë drejtim. Është një shoqëri e dalë nga konflikti që ka përjetuar shkatërrim dhe humbje në njerëz dhe struktura. Është e ndarë në shumë nivele duke përfshirë gjënë më themelore në nivele, gjuhën. Ekonomia e saj është duke kaluar nga ajo e komanduar tek ajo e orientuar nga forcat e tregut. Pagat dhe kushtet e punës janë të varfëra. Shkathtësitë duhet të shtohen. Sektori publik, ta zëmë, është shumë i coptuar që do të thotë se nuk ka traditë bashkëpunimi ndërmjet sektorëve të veçantë, e as që ekziston ndonjë traditë e dhënies së llogarisë. Përveç kësaj, ekzistimi i 'strukturave paralele' për vite me rradhë tregon se ekziston një traditë e paktë e bashkëpunimit me strukturat qeveritare. Këto janë disa nga sfidat që OSBE-ja dhe Kosova duhet t'i tejkalojnë që Kosova të ndryshojë dhe të përparojë.

Një nga synimet kryesore të OSBE-së në Kosovë është ndihma e dhënë për "depolitizim" dhe profesionalizim të institucioneve publike, siç është shërbimi publik, policor, gjyqësor, shërbimi publik i mediave. Kur është fjala për rekrutime dhe promovime, kjo nënkupton trajnime dhe përfshirjen e standardeve të bazuara në meritë dhe efektshmëri,

OSBE-ja vazhdimisht ka përkrahur pjesëmarrjen e njerëzve të Kosovës në të gjitha nivelet e administrimit. Ajo gjithashtu beson se në të njëjtën masë është i rëndësishëm avansimi i institucioneve të reja nën autoritetin e Kosovës. Si rezultat i kësaj, të gjitha strukturat e reja të krijuara apo të reformuara nga OSBE-ja kanë një politikë e cila ka për qëllim bartjen graduale të menaxhimit nga ndërkombëtarët te vendorët. Në vitin 2002, OSBE-ja ka punuar

Për informata të tjera, kontaktoni me

Zyrën për informim publik të OSBE-së, Prishtinë

Zyra e shtypit: +381 38 500 162 ext. 260

Zyra e informimit publik: +381 38 500 162 ext. 145

Fax: +381 38 500 188 E-mail: [press@omik.org](mailto:press@omik.org)

Website: [www.osce.org/kosovo](http://www.osce.org/kosovo)

që të zhvilloj institucione efikase dhe afatgjate të qeverisjes dhe jetës publike që të arrijnë një shkallë të lartë të pavarësisë dhe vetëmbështetjes. Gjithashtu është esenciale që këto institucione të jenë gjithëpërfshirëse, të përfaqësohen dhe t'u shërbejnë në mënyrë adekuate nevojave të shumë komuniteteve të

Kosovës. Avansimi i përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së mbarë komuniteteve si dhe një mirëkuptim dhe respekti më i madh i të drejtave të njeriut janë pjesë përbërëse për të gjitha programet e OSBE-së për ngritjen e kuadrove.

Projektet afatgjata të zhvillimit gjithashtu përfshijnë elementet tjera, përfshirjen më të gjerë të akterëve joshjetërorë, siç janë OJQ-të, përmirësimin e bashkëpunimit me donatorët, teknologjinë e informimit duke përfshirë Internetin. OSBE-ja po kërkon që në mënyrë aktive të mbërthejë të gjitha këto elemente si dhe parimin e transparencës, pjesëmarrjen e secilit duke përfshirë komunitetet e pakicave dhe grupet e tjera të marginalizuara, siç janë femrat si dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe sundimi i ligjit.

### **Programet e OSBE-së për Ndërtimin e Kapaciteteve në Kosovë Njerëzore**

Sa më shumë individë, grupe dhe organizata që mund të kenë qasje ndaj njohurive dhe informacioneve siç janë të dhënat teknike dhe përvojat më të mira, aq më shumë ata janë të autorizuar për të ofruar dhe marrë shërbim cilësor. OSBE-ja është duke punuar për të gjetur njerëzit e duhur për punë, duke u dhënë atyre mundësinë për t'u kualifikuar dhe marrë aftësi të reja dhe të zhvillojnë qasje profesionale ndaj punës së tyre. OSBE-ja është e përfshirë në rekrutimin dhe trajnimin e Shërbimit Policor të Kosovës, komunitetit gjyqësor, Komisioneve të Zgjedhjeve si dhe personelit vendor të saj. Ta zëmë, Shkolla e Shërbimit Policor të Kosovës (SHSHPK) është një nga projektet më të suksesshme të ngritjes së kuadrove në Evropën juglindore. Ajo është duke e bërë trajnimin e 6.300 policëve në shërbim të fortë policor multi-etnik. Policët e ri, pothuajse e kanë fituar respektin e komuniteteve të tyre dhe kanë rritur efektivitetin në zbatimin e ligjit. OSBE-ja gjithashtu mban kurse për gazetarë, ekspertë të të drejtave të njeriut, politikanë, personelin e OJQ-ve dhe punëtorë në shërbimin civil. Instituti për Administratën Civile po ndihmon për të zhvilluar një shërbim civil profesional të papolitizuar, e paparë në Kosovë deri më tani. OSBE-ja tanimë mban trajnime shërbyese për personelin e qeverisë lokale dhe planifikon të iniciojë një program afatgjatë trajnimi për ata të cilët dëshirojnë të hyjnë në shërbimin civil në të ardhmen.

### **ORGANIZATIVE**

Personeli i aftë nuk është i mjaftueshëm për ta bërë shoqërinë funksionale deri në potencialin e saj të plotë. Atyre iu nevojiten hapësira ku mund të punohet si dhe burime teknike, infrastrukturale dhe burime tjera. OSBE-ja ka themeluar tri institucione ligjore të reja të cilat tanimë janë duke bërë ndikim në Kosovë. Qendra Juridike e Kosovës angazhohet në hulumtim, organizon seminarë tematikë për komunitetin ligjor të Kosovës dhe përkrah Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Instituti Gjyqësor i Kosovës mban kurse për gjykatës, prokurorë dhe këshilla për mbrojtje. Qendra e Resurseve të Mbrojtjes Penale punon me avokatët mbrojtës që në mënyrë adekuate të prezantojnë klientët e tyre përmes ndihmës së drejtpërdrejt për raste, hulumtime dhe trajnime. Institucioni i Ombudspersonit

shërben si institucion mbikqyrës që autoritetet të respektojnë të drejtat e njeriut të të gjithë pjesëtarëve të shoqërisë.

Suksesi gjithashtu varet nga mënyra se si menaxhohen dhe rregullohen gjërat dhe se a ekziston burim i sigurtë dhe i qëndrueshëm i fondeve. Deri më tani, mbi 110 radio stacioneve dhe televizione vendore, ndërkombëtare dhe të KFOR-it u është dhënë leja pas një riorganizimi të plotë të frekuencave të Kosovës. Së shpejti, Komisioni i Pavarur i Mediave do të merr përgjegjësitë nga OSBE-ja për të dhënë lejen dhe rregulluar mediat elektronike duke dhënë ndihmesë në avansimin e mediave të pavarura. Dy institucione të mediave kanë filluar me ndihmën e OSBE-së, Radio Televizioni i Kosovës, shërbim publik dhe Kosova Live që janë duke vepruar në mënyrë ta pavarur.

Koordinimi dhe bashkëpunimi është me rëndësi jetike poashtu. Sot ekzistojnë me qindra OJQ që veprojnë në Kosovë. OSBE-ja ka themeluar një forum qendror të OJQ-ve për t'u mundësuar atyre dialog, koordinim të aktiviteteve që të jenë më efektive. Partitë politike poashtu kanë përkrahje në një sërë nivelesh organizative dhe administrative, duke e përfshirë ngritjen e fondeve dhe përgjegjësinë financiare. OSBE-ja është gjithashtu duke i këshilluar ato mbi platformën dhe zhvillimin e politikës.

### **QEVERITARE**

Ndërtimi i kapaciteteve është çështje bazë e qeverisjes. Përparimi varet nga të qenit i hapur, kreativ, transparent dhe përgjegjës. Nëse këto elemente janë prezente në nivel të qeverisë, atëherë përparimi mund të arrihet edhe në nivelet tjera. OSBE-ja është e përfshirë në përkrahjen e strukturave politike, ligjore dhe administrative të Kosovës në praktikë dhe në mënyrat e zhvillimit të politikës.

Zgjedhjet komunale të vitit 2000 dhe ato të përgjithshme të vitit 2001, ishin një përvojë e madhe për Kosovën ku mund të nxirreshin mësim. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përbëhej kryesisht prej personave vendorë nga të gjitha shtresat e shoqërisë të cilët kanë pasur sukses në mosndikimin e politikës partiake në diskutimet dhe vendimet e tyre. Rregullat e Zgjedhjeve që ata i kanë miratuar i obligojnë partitë politike të merrnin pjesë në zgjedhje dhe të përmbushnin standardet bashkëkohore dhe demokratike.

OSBE-ja vazhdon të ketë një rol të madh e origjinal në përkrahjen e Institucioneve qeverisëse të Kosovës përmes Zyrës së Qeverisjes së Mirë. Roli i saj është të ngris vetëdijen dhe të përfshij parimet e transparencës, pjesëmarrjes së popullatës, mundësive të barabarta, respektimin e të drejtave të njeriut dhe pavarësimin e mediave dhe të OJQ-ve në procesin vendimmarrës dhe të hartimit të parimeve në nivel më të lartë.

OSBE-ja gjithashtu është duke e bërë monitorimin e funksionimit të sistemit gjyqësor në Kosovë. Monitoruesit bëjnë vëzhgime kritike por me qëllim të qartë të ndihmojnë në përmirësimin e mbajtjes së gjykimeve dhe të sigurohen se i përmbahen standardeve ligjore ndërkombëtare.

